

HISTORI FIKSIONALE PËR NJË EPOKË REALE (STUDIM MBI ROMANIN “NJË DASHURI DHE SHTATË FAJE”)

Albin MEHMETI*University of Prishtina***Abstrakt**

Ky studim analizon romanin “Një dashuri dhe shtatë faje” të Rexhep Qosjes, një vepër që ndërthur letërsinë artistike dhe dokumentaren historike për të trajtuar sfidat e identitetit kombëtar shqiptar në periudha kritike historike. Përmes personazheve fiktivë, të cilët mbartin elemente të qarta nga realiteti, autori ndriçon ngjarjet politike dhe sociale që shënjuan historinë shqiptare në Kosovë gjatë shekullit XX. Në veçanti, shqyrtohet ndikimi i represionit ideologjik, lufta për liri dhe integriteti i intelektualëve shqiptarë në një shoqëri të fragmentuar mes tradhtisë dhe besnikërisë. Përmes një narrative të pasur në simbolikë dhe reflektime historike, studimi synon të nxjerrë në pah rolin e letërsisë si mjet për dokumentim dhe ndriçim të së vërtetës historike.

Hyrje

Letërsia shpesh shërben si një pasqyrë e shoqërisë, duke nxjerrë në pah konfliktet, aspiratat dhe realitetet historike të një kohe të caktuar. Në këtë kontekst, vepra “Një dashuri dhe shtatë faje” e Rexhep Qosjes shquhet si një narrative që sfidon kufijtë mes fiksonit dhe realitetit, duke ndërthurur njëkohësisht elemente dokumentare dhe artistike. Ky roman nuk është thjesht një rrëfim i një historie personale, por një dëshmi për epokat e trazuar të shqiptarëve të Kosovës, ku personazhet fiktivë shërbejnë si alter ego të figurave reale. Përmes figurave si Çerem Çapari dhe situatave historike të ndërthurura me ngjarje imagjinare, Qosja krijon një mjet reflektimi për lexuesin bashkëkohor mbi peripecitë e një populli të shtypur dhe përpjekjet për ruajtjen e identitetit kombëtar. Kjo hyrje synon të ndriçojë bazën konceptuale të romanit dhe rëndësinë e tij si një monument letrar që sfidon interpretimet tradicionale të historisë.

Një paraqitje e shkurtër e romanit

Vepra “Një dashuri dhe shtatë faje” fillon me një paratekst i marrë nga vepra “Tre tigra të trishtë” të Gilermo Kabrera Infante ku thotë: *Megjithëse të bazuara në persona vërtet, ekzistues, personazhet paraqiten si qenie të imagjinuara. Emrat e veçantë në këtë libër duhet të trajtohen si pseudonime. Ngjarjet, të shpeshtën e herës të marra nga jeta, pas trajtimit, duken si të trilluara. Çdo ngjashmëri mes letërsisë dhe historisë është rastësore.*¹ Përmes këtij citimi, autori na jep një çelës se si duhet ta lexojmë veprën. Përmes këtij citimi, Qosja në bën të qartë se kemi të bëjmë me një vepër, e cila para se të jetë një vepër letrare, mëton të bëhet vepër dokumentare, që përmes letërsisë provon t’u dëshmojë brezave, e pse jo edhe botës një ngjarje historike. Përmes personazheve që tani ai i quan personazhe letrare paraqet persona realë, të cilët janë protagonistë të një periudhe të caktuar historike. Gjithmonë sipas këtij citimi që luan rolin e një ure lidhëse mes ngjarjeve reale dhe fiksonit qosjan do të ndeshemi me personazhe, të cilët edhe pse janë ne pseudonime nënkuptohen se cilët janë ata, qofshin ata personazhe të cilët duhet të krenohen me veprat e tyre apo qofshin personazhe që do t’i gjykojë historia

¹ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2010, faqe 5.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v12.i23-24.p2872>

nacionale si njerëz të ligë. Ndoshta edhe ky ishte qëllimi i Qosjës, pra gjurmimi i të vërtetave për personazhe që në publik konsiderohen hero dhe realisht janë tradhtarë ose/dhe anasjelltas. Në pika të shkurtra, subjekti i veprës përfshin jetën e kryepersonazhit Çerem Çapari dhe sfidat e tij në përballje me pushtetin. Botuesi Arben Begeja e takon Çeremin në SHBA, ku ky i fundit ia japë atij dorëshkrimin e tij, i cili më shumë është ditar personal i tij, ku kërkon nga Begeja që ta botojë atë. Jeta e Çeremit në SHBA, një jetë me plot peripeci është jeta e gjithë intelektualëve shqiptarë, të cilët u detyruan ta lënë vendlindjen për shkaqe politike, për shkaqe të sigurisë personale dhe familjare.

Dorëshkrimi i Çeremit nuk ka titull, të cilin botuesi Begeja më pas duhet t'ia vë emrin, "*Një dashuri dhe shtatë faje*". Vepra fillon me një shënim nga Monteske, në të, cilin ai flet për fatin e popujve të lirë dhe të robëruar, për fatin e banorëve në shtete despotike. Si për ironi, kjo i përshtatet tej mase fatit të popullit të Çeremit.

Paralajmërimi i një stuhie

Në fillim të veprës është tregimi "Profeti më kishte thënë" në të cilën paraqitet ardhja e një njeriu të mistershëm të quajtur Mihran. Mihrani është një lloj profetizuesi, i cili përmes fjalëve të tij paralajmëron ndodhitë që do të ndodhin në të ardhmen. Sipas shënimeve, ngjarja është duke u zhvilluar menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë tregim, Qosja përmes narratorit Çerem Çapari na jep tabllon e Vajazanit, pra që gjithmonë duhet ta nënkuptojmë si Prishtinën, në të cilën *disa njerëz të huaj e të vendit i sundojnë njerëzit e tjerë, si të ishin rrogëtarë të tyre*.² Kjo paraqet një realitet historik të kohës, konkretisht gjendjen e Prishtinës konkretisht të Kosovës, ku pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kombe të ndryshme sllave, por edhe vetë shqiptarët u bashkuan rreth një ideologjie, komunizmit, ku për një kohë të gjatë përdorën metodat më barbare për t'i sunduar ata. Më tej, në vazhden e parashikimeve të Mihranit, ai parashih edhe luftëra të tmerrshme që do të ndodhin në këto hapësira në fund të shekullit, që duke ditur nga historia edhe e dimë për konfliktet e luftërat e përgjakshme që ndodhën në ish Jugosllave në dekadën e fundit të shekullit XX.

Mihrani, çdo herë e më shumë është më konkret në parashikimet e tij. Ai thotë se *të paharruar do të jenë viti 1951, 1953, 1957, 1966, 1968, 1974 dhe mbi të gjithë, viti 1981*.³ Me kalimin e kohës do të shohim se vitet që përmenden në profecinë e Mihranit do të jenë vitet decizive për fatin e shqiptarëve në këto vende, ku vlen të theksohen viti 1957 që është viti i kulminacionit të dhunës dhe terrorit rankoviqian, 1968, viti i demonstratave të studentëve për lejimin e simboleve etnike, viti 1974, viti i ndryshimeve të mëdha kushtetuese si dhe viti kulminant, 1981, kur do të ndodhin protestat e mëdha studentore, që do t'i lëkundin seriozisht themelet e Jugosllavisë si dhe ideve komuniste të bashkim vëllazërimit. Në një çast, Mihran Kumani del përtej aftësi të tij të parashikimit për tridhjetetë vjetëve, dhe si në amulli parashikon edhe dy vite të rëndësishme, atë të 1989 dhe 1999, ku iu drejtohet fshatarëve duke iu thënë se *i pari* (vit është) *i rëndësishëm për krejt botën, kurse i dyti i rëndësishëm për ju dhe vëllazërit tuaj, që janë e s'janë këtu*.⁴ Përmes një personazhi fiktiv, pra të një profeti, Qosja na jep edhe dy data të rëndësishme, atë të vitit 1989 që paraqet fillim fundin e shembjes së diktaturave komuniste në botë si dhe vitin 1999 që paraqet fundin e sundimit të egër të Serbisë mbi Kosovë. Në mes të kësaj katrohure dhe frike që sjellë Mihrani, ai në një rast do të ta japë një fije shprese, kur thotë se *këtu ku jam tashti, atij, që do t'u rrijë të tjerëve gjel mbi krye, atij do t'i bien puplat njëherë e mirë*.⁵ Pra shpresa në mes të kësaj stuhie që do të ndodhte është se pas shumë peripeceve, armiku që për shumë kohë do të qëndrojë duke sunduar do të largohet një herë e mirë nga këtu. Ky paraqet një fakt historik, ku në fund të shekullit, vite të cilat Mihrani i sheh të amullta, do

² Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 21.

³ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 43.

⁴ Po aty.

⁵ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 46.

t'i vijë fundi sundimit të egër të serbëve mbi shqiptarët. Mes gjithë viteve që përmend, do të jetë viti 1981, të cilën ai e quan *viti që do të shkruhet me dy njëshe, një tetëshe dhe një nëntëshe*, do të jetë viti vendimtar për fatin dhe historinë e këtij populli. Përkishtë ky vit do të jetë viti, i cili do të jetë vendimtar edhe për fatin e kryepersonazhit Çerem Çapari dhe personazheve tjera. Fundi i Mihran Kumanin do të jetë po aq misterioz sa edhe vetë jeta e tij. Nuk do të dihet a u vetëvra, u vra apo vdiq nga sëmundjet natyrale. Dyshimet se u vra ishin më të mëdha sesa opsionet tjera. Dilema e vrasjes së tij ngritë edhe një fakt tjetër historik, që ka ndodhur shpeshherë në Jugosllavi por edhe në Republikën Popullore të Shqipërisë. Njëra nga dyshimet se pse u vra Mihrani ishte se atë *e ka vrarë policia për shkak të dyshimit se ishte agjent nga një shtet fqinj*.⁶ Pas prishjes së marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, shumë shqiptarë u vranë me dyshimin se ishin agjentë të shteteve respektive.

Fillimi i stuhisë së parashikuar

Parashikimet e profetizuesit Mihran Kumanit trokitën në dyert e vajazanasve. Tani ata do të përballeshin me vitin e ndryshimeve të mëdha. Po fillonin të ndodhnin demonstratat e mëdha studentore të Universitetit të Prishtinës që do të jenë zgjimi i popullit shqiptar. Tani në dorëshkrimin e Çeremit do të ndeshim personazhe fiktive, profesorë e intelektualë që de facto janë profesorët dhe intelektualët realë që përbuzën, shanë, i akuzuan, por në raste të rralla edhe i mbrojtën protestat e studentëve të tyre që ishin sublimim i gjithë idealeve të popullit shqiptar ndër vite e dekada. Në mesin e tyre do të ndeshim profesor si Mexhid Toja i cili do të heshtë gjatë gjithë kohës, heshte me të cilën edhe do të shpërblehet nga pushteti, heshtje për hir të së cilës *do t'ia dëgjoni emrin në ndonjë ofiq të lartë në Vajazan*.⁷ Pra, Mexhid Toja është arketipi i shumë profesorëve e intelektualëve, të cilën në vend të përkrahjes, zgjedhën rrugën e kundërshtimit, qoftë ai publik apo edhe përmes heshtjes, vetëm e vetëm për t'i plotësuar egot personale të tyre, për përfitime postesh partiake, akademike a shtetërore.

Zhvillimi i ngjarjeve në roman fillon pas zhvillimit të demonstratave. Qosja, gjithmonë përmes narratorit Çerem Çapari përmes metaforës së sëmundjes paraqet ndryshimet që kanë ndodhur në Vajazan pas zhvillimit të këtyre organizimeve studentore, ku ai thotë se *këto ndryshime mund të quhen sa kimike aq edhe biologjike dhe kjo domethënë se shkaktari i sëmundjes është një kundërtrup me përbërje virusi- dhe kundërvirusi*.⁸ Përmes kësaj konkluze, ai paraqet idetë të cilët rrodhën nga fjalimet e shumë udhëheqësve të kohës, serbë apo shqiptarë, të cilët këto demonstrata i panë para se gjithash si ndryshime të këqija dhe si regres, apo siç e quan Çeremi, *si ndryshime në pjesën e trurit të quajtura shala turke*.

Pas mbarimit të demonstratave filloi lufta ndaj çdo gjëje që ishte dhe që lidhej me etninë shqiptare. Çeremi fillon të rrëfejë se si çdo gjë që ishte kuq e zi hetohej. Në pjesën e veçantë të *Fletoreve të shënimeve*, ai rrëfen se si studentet dhe studentët të cilën rastësisht kishte të veshur rroba me ngjyra kuqezi maltretoheshin e rriheshin nga policia serbe. Në lidhje me këtë, në librin historiko-politik “Çështja shqiptare- historia dhe politika”, vetë Qosja rrëfen se shqiptarët arrestoheshin *pse ishin veshur me rroba në të cilët shquanin ngjyrat kuq e zi- ngjyrat e flamurit kombëtar shqiptar*.⁹

Në kapitullin *Kolona e pestë e shejtanit* ndër të tjerat paraqitet edhe një sulm masovik i qenve nëpër rrugët e Vajazanit kryesisht ndaj intelektualëve të vendit. Qentë që sulmonin janë alegori e sulmeve të pushtetit ndaj intelektualëve që refuzonin diferencimin ideo-politik, kurse zëri misterioz që ndërsente qentë që të atakoheshin njerëzit në rrugë ishte zëri i atyre intelektualëve kameleonë shqiptarë që nxitnin pushtetin kundër bashkëkombësve të tyre, pra duke i fryrë zjarrit të persekutimit ndaj shqiptarëve në atë kohë. Më tej, kryepersonazh i romanit, Çerem

⁶ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 53.

⁷ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 110.

⁸ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 107.

⁹ Qosja, Rexhep, *Çështja shqiptare- historia dhe politika*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, faqe 203.

Çapari, teksa po shëtitej nëpër rrugët e Vajazanit, do të ndeshet me llavën e qenve, të cilët e sulmojnë, dhe ky u drejtohet atyre me emrat Maksi e Reksi dhe emra tjerë të huaj. Ky është pasqyrimi i gjendjes pas demonstratave, kur në Kosovë me urdhër federativ në Kosovë zbarkuan policë dhe njësite speciale nga Republikat tjera të Jugosllavisë. Sipas të dhënave historike, *me 2 prill (1981), Beogradi pasi dërgoi trupa shitesë në Prishtinë dhe njësi të shumtë policore të cilat nuk ishin në gjendje të shuanin demonstratat shpalli gjendjen e jashtëzakonshme*.¹⁰

Në pjesën tjetër të “Nga fletorja e shënimeve” mbipërdoret fjala *diferencim*. Në këtë pjesë ai tregon për periudhën e diferencimit ideo-politik që ndodhi pas demonstratave të 1981. Autori, në këtë rast Çeremi si narrator përmes përdorimit të tepërt të fjalës diferencim, ai tregon terrorin që pësonte populli. Diferencimin e hasje kudo e në çdo kohë, apo siç thotë veç Çeremi *e dëgjojmë çdo ditë, madje, çdo çast, prej mëngjesit e në mbrëmje dhe prej mbrëmjes e në mëngjes në radio e në televizion*.¹¹ Kjo periudhë që ndodhi në Vajazanin e Çeremit ishte një realitet i hidhur në Prishtinën e Qosjes. Këtë kohë, në çdo institucion shtetëror, udhëheqësit dhe punonjësit u detyruan që të dalin publikisht para kolektivit dhe udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave dhe t’i kundërshtojnë protestat studentore dhe idetë e tyre, me fjalë të tjera përmes tyre të shprehin besnikërinë e tyre ndaj komunizmit, internacionalizmit, bashkim vëllazërimit si dhe ndaj Republikës Federative të Jugosllavisë.

Pas demonstratave të 1981, por edhe më herët, lufta ndaj shqiptarëve në IRFJ, e veçanërisht në Kosovë, nuk ishte vetëm luftë politike, por ajo kaloi edhe në domenin e luftës kulturore. Janë të njohura rastet kur shumë këngëtarë, aktorë e shkrimtarë u dënuan vetëm pse në artin e tyre pasqyruan pjesën nacionale të shqiptarëve. Personazhi fiktiv, këngëtarja Tereza Tupeci dënohet me dy vite burgim vetëm pse ka kënduar këngën *Bubullimë te shkëmbi i Kavajës, e cila nxit ndjenja dhe mendime dashurie për njerëz dhe qytete të huaja*.¹² Kjo luftë ndaj kulturës e artit shqiptar u egërsua edhe më shumë pas ngjarjeve të 1981 dhe vazhdoi më fuqishëm pas suprimimit të autonomisë së Kosovës e deri në lirinë e Kosovës më 1999.

Fjalori fiksional si shpjegues i realitetit

Në kapitullin “*Fjalori i fshehur*” kemi fjalorin e krijuar nga Çeremi, përmes se cilit përshkruan fenomene e njerëz, ngjarje e fjalë nga më të ndryshmet, përmes së cilës, në të shumtën e rasteve tregon një realitet të djeshëm e të sotshëm. Brenda këtij fjalori mund të gjejmë edhe personazhe fiktive e reale, të cilat kanë vetëm një mision, njohjen e së vërtetës.

Në shpjegimin e fjalës *kameleon* ai përshkruan njerëzit e pushtetit dhe servilët e tyre, që gjithmonë në bazë të rrethanave të tyre ndërrojnë gëzofin e ngjyrat e tyre ideologjike. Njerëzit e tillë janë të aftë që brenda ditës të ndryshojnë. Njeriu kameleon është i aftë që *ta ndërrojë ngjyrën saora dhe t’u përshtatet rrethanave në të cilat e sjellin fati a fatkeqësia: ditën është i gjelbër, natën i zbardhëllemë e në diell i murrët*.¹³ Njerëzit e tillë u shfaqën çdo herë, sidomos në kohë trazirash e ndërrimesh politike. Nuk është e rastësishme që edhe pas demonstratave të shihje njerëz të tillë kudo, të cilët për interesa personale ndërruan bindje. Të tillët në diskursin politik e social quhen pa kurrizorë, njerëz që në diskursin popullor shqiptar janë njerëz që nuk u prenë sakica në një vend. Ngjashëm me shpjegimin e fjalës kameleon, ai shpjegon edhe një fjalë tjetër simotër, *orëçuet*. Orëçuet në të vërtetë është kategori e njerëzve të cilët janë të gatshëm t’i kapen çdo pushteti. Njerëzve të tillë gjithmonë *u ecën kungulli mbi ujë, si më 1942, si më 1981*.¹⁴ Të tillë njerëz janë të aftë të bëhen nazistë e partizanë të njëjtën kohë. Të tillët

¹⁰ Buxhovi, Jusuf, *Kosova- nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar*, SHB Faik Konica, Prishtinë, 2012, faqe 392.

¹¹ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 160.

¹² Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 244.

¹³ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 170.

¹⁴ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 175.

janë nacionalistë e internacionalistë. Të tillë janë të aftë të shndërrohen në çfarëdo specie që iu kërkon koha.

Më tej, përsëri rikthehet tema e diferencimit, konkretisht shpjegimi i foljes *diferencohet*. Kjo folje shpjegohet përmes diferencimit që e kishte bërë poeti Baki Zaku), i cili në fjalimin e tij shprehu admirimin që ka për LKJ dhe se betimi i tij që deri në vdekje do t'i shërbejë kësaj ideologjie. Ky është kulmi i dëshpërimit, atëherë kur sheh njerëz, të cilët duhej të ishin fanari ndriçues i popullit për të ecur drejt lirisë, janë pikërisht shtresa intelektuale ata që i shërbyen ideologjive të huaja. Baki Zaku është një personazh fiktiv romanor, por në të vërtetë ai mund të jetë një person real. Ai mund të jetë një nga poetët e kohës, pjesë e shtresës intelektuale shqiptare që dënoi ashpër protestat studentore. Pra, këtu kemi bashkëveprimin e fiksionit me faksionin, pasi diferencimi ideopolitik ishte një gjë reale, një fakt historik kurse shumica e personazheve ishin fiktive, të krijuara nga Qosja, të cilët disa i shërbyen pushtetit dhe disa të tjerë pësuan shkaku i kësaj. Baki Zaku është një personazh fiktiv romanor, por në të vërtetë ai mund të jetë një person real. Ai mund të jetë një nga poetët e kohës, pjesë e shtresës intelektuale shqiptare që dënoi ashpër protestat studentore. Përmes fjalimit të Baki Zakut do të shohim arketipin e poetëve që gjatë gjithë historisë i shërbyen pushteteve. Janë të njohur shkrimtarët oborrtarë, të cilët shërbyen në rezidenca udhëheqësish, duke shkruar për ta dhe duke i lavdëruar qeverisjet e tyre. Në esenë "Refuzimi estetik", Ibrahim Rugova sqaron hollësisht problematikën e shkrimtarëve të oborrit. Ndër të tjera, ai tha se që nga antika greke, por edhe në *mesjetë në kishë dhe më vonë në oborret mbretërore mbahen shkrimtarë për madhërimin e mbretërve dhe pushtetarëve të ndryshëm*.¹⁵ Pra, Baki Zaku nuk është diçka e re, nuk është një fenomen i ri që është shfaqur për herë të parë në këtë kohë dhe tek ne. Ai është vetëm një vazhdimësi në histori u shërbyen pushteteve, mbretërve e diktatorëve. Më tej, Rozaf Gashi, edhe ky personazh fiktiv, por në dallim nga Baki Zaku, paraqet qindra intelektualë shqiptarë të cilët u dënuan dhe u persekutuan për shkak që ishin kundër ideve false të bashkim-vëllazërimit. Ai do të akuzohet edhe nga bashkëkombësit e tij intelektualë për veprën *Roli i inteligjencies në luftërat botërore*, si vepër atentat kundër bashkim vëllazërimit. Brenda veprës do të hasim edhe personazhe fikzionale por që në të vërtetë ishin personazhe reale dhe figura kyçe në zhvillimin e historisë kombëtare të asaj periudhe. Man Kurti, profesori vajazanas, i njohur në për njohjen e historisë kishin filluar t'i fshiheshin dhe ngatërroheshin të dhënat historike për lashtësinë e popullit shqiptar. Nga gjendja e rënduar, dhe nga sëmundja metaforike që gjithmonë duhet ta kuptojmë represionin që bëhej mbi intelektualët, Man Kurtit kishin filluar t'i fshiheshin *të dhënat e rendit të gjashtë, domethënë të dhënat historike, kurse ndër to, më së pari të dhënat për të kaluarën e shqiptarëve*.¹⁶ Man Kurti, si një personazh fiktiv, i krijuar nga imagjinata e Qosjes është intelektual shqiptar, mbi të cilin pushteti përdori metoda çnjerëzore qofshin ato fizike e psikologjike për ta shkatërruar atë. Shkatërrimi i intelektualëve, në raste kur nuk funksiononte blerja e tyre ishte metodë e frikësimit të masës së gjerë të popullit, të cilët kur do të shohin tmerrin që intelektual ka pësuar, ata do të zbrazen nga idealet e tyre. Nga përshkrimet dhe veçoritë e Man Kurtit, ai mund të nënkuptohet si Ali Hadri, drejtori i atëhershëm i Institutit të Historisë i cili u sulmua nga *Organet e LKJ-së, Lidhja e Luftëtarëve të LNÇ-së të Jugosllavisë si dhe organet tjera shtetërore kërkuar që profesori të largohej nga pozita e drejtorit si dhe të merreshin masa ndëshkuese duke përfshirë këtu edhe burgosjen e tij*.¹⁷ Pra përmes burgosjes dhe largimit nga puna të profesor Ali Hadrit, atij do iu pamundësohet të flasë në publik, që t'i paraqes mendimet e tij rreth zhvillimeve politike por edhe që t'ua bëjë të ditur popullit historinë e vërtetë të shqiptarëve dhe problemit socio-politik e historik të Kosovës. Tjetër personazh real por që pasqyrohet përmes emrit fiktiv, është edhe profesori Ukshin Hoti, që në vepër na del me emrin Ukshin Mati. Personazhi fiktiv Ukshin Mati, i posapranuar në *Fakultetin e Sociologjisë*

¹⁵ Rugova, Ibrahim, *Refuzimi estetik, Rilindja*, Prishtinë, 1987, faqe

¹⁶ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 149.

¹⁷ Keçmezi-Basha, Sabile, *Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003, faqe 80.

dhe Filozofisë, në mbledhjen e organizatës themelore të LK-së, në të cilën po bëhej diferencimi ideopolitik, thotë se demonstratat e studentëve dhe të rinisë shkollore nuk janë armiqësore, sepse kërkesat e ngritura në to nuk cenojnë interesat e askujt.¹⁸ Profesori Ukshin Hoti, i cili më pas, në vitin 1982 do të dënohet më nëntë vjet burg me akuzën për veprat penale të tentim rrëzimit të pushtetit të klasës punëtore dhe të punonjësve, thyerjen e bashkim-vëllazërimit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ, do të dalë haptas për padrejtësitë që iu shkaktuan popullit shqiptar që nga Konferenca e Bujanit.

Në shpjegimin e fjalës *burg*, sqaron se kjo fjalë nënkupton vendin ku çohen njerëzit që flasin kundër pushtetit dhe partisë, si dhe kundër socializmit. Nuk janë të rralla rastet kur qytetarët e vendeve socialiste që përfshihet edhe Jugosllavia u dënuan me dënime të rënda vetëm pse kundërshtuan pushtetin dhe politikën e tij, apo edhe shanë sistemin socialist. Në dallim prej vendeve të tjera socialiste, në Jugosllavi ishte edhe një arsye shtesë për t'u mbushur burgjet me njerëz. Për shqiptarët, si grupi etnik më i persekutuar në Jugosllavi mjaftonte një faj fare i vogël që të burgoseshin e të dënoheshin me dënime me të rënda, të cilat u shtuan me të madhe pas demonstratave të 1981, por edhe pas lëvizjeve të vogla antipushtet veçanërisht në Kosovë. Në shpjegimin për këtë fjalë tregohet edhe një fakt historik tjetër, ai i përmendjes së heronjve shqiptarë që lanë gjurmë në histori. Qosja thotë se burgu është vendi ku çohet *ai që përmend shpesh Abdyl Frashërin dhe, sidomos, Mithat Frashërin*.¹⁹ Këto dy personazhe historike, i pari si prijatar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe sidomos i dyti si udhëheqës i Ballit Kombëtar, ishin persona *non grata*, të cilët edhe për së vdekuri ua prishnin planet për bashkim-vëllazërim, por që në fakt ishin plane të hegjemonizmit serb. Nuk janë të rralla rastet kur njerëzit u dënuan vetëm pse kanë përmendur figura historike e prijatë të nacionalizmit shqiptar, apo edhe pse kanë recituar e mbajtur librave të shkrimtarëve të ndaluar të kohës, siç ishte rasti i veprës *Lahuta e Malcisë* e Gjergj Fishtës.

Nuk janë të rralla raste kur njerëzit e të njëjtës përkatësi, qoftë etnike apo ideologjike, janë ata që ndihmojnë më shumë palën tjetër, dhe shpeshherë ata janë më të fuqishmit dhe më së shumti që dënojnë vëllezërit e motrat e tyre. Në shpjegimin e fjalës *inkuizitor* thuhet se është ai njeri, i cili në vend që të mundohet ta ndalojë zjarrin në turrën e druve, përkundrazi ai *shkoqet prej turmës dhe në turrën e ndezur të druve qet krande dhe i nxen duart*.²⁰ Nxehja e duarve duhet të nënkuptohet si përfitim personal karshi një interesi të përgjithshëm. Janë dhjeta raste, mos edhe qindra, kur njerëzit në Kosovë, qoftë në sistemin e kaluar, por edhe në sistemet pararendëse, shpifën dhe akuzuan të tjerët pa të drejtë, vetëm që të përfitojnë një asht a kockë nga pushteti. Ata s'ka se si të quhen ndryshe përveç se inkvizitor, që të kujtojnë skenat e llahtarshme të mesjetës, kur intelektualët e njerëzit e ditur u vranë dhe u persekutuan për të vërtetën. Inkuizitorët mund t'i hasim edhe më tej në fjalorin qosjan, por me emërtime të ndryshme, por që të çojnë drejt të njëjtit kuptim, njerëzve bashkëpunëtorë të së keqes. E tillë është edhe fjala *bashkësundimtar*. Kjo fjalë, që nuk është e vështirë për t'u kuptuar kuptohet si bashkëpunim të dy a më shumë njerëzve për të sunduar. Por, Qosja nuk ndalet vetëm me një shpjegim të thjeshtë. Ai thotë se bashkësundim është edhe *kur sunduesi vendës bashkësundon me një pushtues të huaj*.²¹ Pra, për Qosjen ky është kulmi i sherrit, kulmi i së keqes dhe fundi i njerëzillëkut. Kjo nuk është diçka e re. Gjatë historisë së njerëzimit, por edhe gjatë historisë shqiptare në veçanti, kemi raste të shumta kur vetë vendësit u bënë bashkë me pushtuesit për ta sunduar popullin e vet. Këta njerëz, te të cilët është e mbjellë etja për pushtet nuk shikojnë mjetet për të arritur deri të pozita. Ata janë makiavelistë të regjur tek të cilën vlen maksima e Makiavelit se *qëllimi e arsyeton mjetin*. Qosja, për këtë grup të njerëzve shprehet se për ta

¹⁸ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 198.

¹⁹ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 181.

²⁰ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 181.

²¹ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 183.

*kryesore është të sundosh qoftë edhe me dreqin a të birin e tij, se një herë vjen vera nga dera.*²² Këtë grup të njerëzve do të mund ta ndeshësh çdo kohë e në çdo vend, se për ta pushteti është zot.

Qosja, duke njohur mirë mentalitetin ballkanas do të sqarojë fjalë përmes të cilave do të paraqes një të vërtetë historike dhe veçori të ballkanase. Në shpjegimin e fjalës *ardhacak* do të trajtohet problematika në të cilën e ka shoqëruar Ballkanin më shekuj dhe veçanërisht fundshekullin XX. Në retorikën nacionaliste ballkanase, të cilën e hasim edhe në ditët e sotme shohim ndeshjet e ideve të *djepeve të kombeve* apo edhe miteve të lashtësisë, apo e kundërta e saj, etiketimi i kombit tjetër si *ardhacak*. Këtë fjalë, Qosja nuk e paraqet si ndeshje mes kombeve, por ndeshjen mes qytetarëve dhe fshatarëve, por që nga nënteksti nënkuptohet se ka të bëjë me ndeshjen e ideve të shqiptarëve dhe serbëve, dhe gjithë kjo vërehet në fjalinë kur thotë se *ardhacakë duhet të quhen të gjithë ata që kanë ardhur prej përtej bjeshkëve dhe tani e kanë bukën dhe e pinë ujin e Vajazanit, duke na shitur mend si të ishin të lindur e të rritur këtu.*²³ Në fjalinë e mësipërme do të shohim pjesën *përtej bjeshkëve*, e cila është pjesë përbërëse e retorikës nacionaliste shqiptare, e cila përdoret si ofendim dhe argument për sllavët e ardhur në Ballkan prej përtej maleve Karpate. Qosja, problematikën e ardhacakëve e përmend edhe më vonë. Ai teksta përshkruan veçoritë e tyre, d.m.th sllavëve, ai thotë se nuk është çudi se pse pikërisht është Ballkani, vendi në të cilin është krijuar legjenda mbi Drakulën, mit i njohur botëror për vampirizëm, dhe tradhti ndaj miqve dhe atyre që i strehon brenda shtëpisë. Sllavët, apo ardhacakët siç quhen, pas shtrirjes së tyre në këto troje, do të bëhen *mendimtarë të dhunës dhe dhunues të lirisë në Ballkan.*²⁴

Personazhet historike në fjalorin fiktiv

Brenda fjalorit fiktiv të Qosjes do të hasim edhe përmendjen e emrave historikë shqiptarë e të huaj. Një shpjegim i veçantë do të jetë për heroin e Kosovës, Azem Galicën. Përveç se e përmend, Qosja e tregon shkurtazi edhe historinë e tij reale, kryengritjet dhe impaktin që ai e pati në zhvillimet e tjera historike. Përveç pasqyrimin të jetës së tij, ai tregon edhe një realitet tjetër, i cili ka të bëjë me legjislacionin i cili ekzistonte në kohën në të cilën është shkruar vepra, pra periudha moniste, përkatësisht fillim vitet e tetëdhjeta të shekullit XX. Sipas Qosjes, edhe përmendja e autorit paraqet një rrezik në vetvete, pasi *po ia përmende emrin për të mirë të presin më së pakti dhjetë vjet burg të rëndë.*²⁵ Veç kësaj, tek shpjegimi për Azem Galicën, tregohet edhe një problematikë tjetër, ajo e persekutimit të familjeve edhe pas vrasjes së kryengritësve. Kur flet për motrën e Azem Galicës, thotë se edhe pse ajo është gjallë diku në Prekaz, askush nuk guxon as të shkojë tek ajo, por as të pranojë atë në shtëpi.

Përveç personazheve historike shqiptare, të cilët disa i përmend shkarazi e disa më veçantë, Qosja gjithashtu përmend edhe personazhe nga historia botërore, ndër ta edhe Kaligulën. Kaligula është perandor romak, i cili ka mbetur në histori për shkak të çmendurive të tij. Ai është vetëm një nga shumë udhëheqës, mbretë, perandorë e diktatorë, të cilët historia do t'i njoh vetëm çmenduritë e tij. Kjo është e vërtetë historike, që përveç pedestalit të historisë ku hyjnë heronjtë e udhëheqësit e drejtë, historia ka edhe pjesën e njerëzve të ligë, që fatkeqësisht faqet e saj janë më të shumta sesa ato të historisë së ndritur.

²² Po aty.

²³ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 185.

²⁴ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 241.

²⁵ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 207.

Dokumentet fikzionale si shpjeguese i realitetit

Një veçori tjetër e veprave postmoderne është edhe inkuadrimi i dokumentit brenda veprës letrare. Kësaj radhe, Qosja inkuadron dokumentin fikcional, apo *Dosjen ÇÇ*, në të cilën janë *dokumentet për jetën dhe veprimtarinë armiqësore të personit të vëzhguar- Çerem Çapari*. Në këto dokumente në detaje tregohet për jetën dhe veprimtarinë e Çeremit, madje hetuesia ka shkuar aq larg, sa që kontrollon edhe ndërdijen e autorit, duke ia analizuar ëndrrat që ai i ka parë. Në këtë dokument ndër të tjerave është edhe shpjegimi për zhvillimin e demonstratave dhe të tjera të ngjashme.

Dokumentet fikzionale fillojnë më një të dhënë historike që ka të bëjë me vendin e fillimit të demonstratave të 1981, pra në mensën e studentëve. Në dëshmitë e hetuesve të rastit kundër të pandehurit Çerem Çapari, ndër të tjera është edhe audio kaseta në të cilën dëgjohen të brohoriturat që gazetari Sylejman Ajkani i quan nacionaliste gjatë demonstratave, të cilat pikësëpari u dëgjuan në mensë, për të vazhduar më pas në rrugë, në shesh dhe për t'u rikthyer përsëri ë vendin e njëjtë në mensë. Në të vërtetë, ky ishte edhe lëvizja e demonstruesve në ditën e parë të demonstratës.

Më tej, NT, rojtar në Morgun e Spitalit të Madh, që edhe ky si Sylejman Ajkani, është personazh fiktiv dëshmon që si pasojë e demonstratave, në Morg janë *sjellë trupat e të vrarëve, njëzet e nëntë djem dhe katër vajza*.²⁶ Dëshmia fikzionale e personazhit fiktiv na del të jetë edhe e dhënë fiktive, jo e saktë e të vrarëve, pasi *sipas të dhënave zyrtare, u plagosën 17 policë dhe 15 demonstrues. Pati gjithashtu mjaft të vdekur, por zyrtarisht u pranuar 9 qytetarë dhe 2 policë*.²⁷ Demonstratat e vitit 1981, përveç që ngritën tensione brenda për brenda Jugosllavisë, ato ngritën edhe tensione mes dy shteteve, atij jugosllav dhe atij shqiptar. Ky tension u bë për arsye të akuzave që udhëheqësit jugosllavë i bënin në drejtim të Shqipërisë në lidhje me organizimin e këtyre demonstratave. Fjalimi fikcional i NX, sekretar i Komitetit të LK-së të Qytetit të Vajazanit, shprehen qëndrimet e vërteta të udhëheqësve komunistë jugosllavë. Në këtë fjalim ai shprehet se organet e tyre të sigurimit *kanë mbledhur të dhëna të pamohueshme për rolin e dyshimtë të Shqipërisë enveriste në organizimin e këtyre demonstratave*.²⁸

Në dokumentin nr. 13 që në fakt është pjesë nga ditari i Çaremit ndërlidhet me ëndrrën simbolike që kishte parë ai. Në këtë ëndërr, Çaremi sheh një ambient të zhveshur tërësisht, që më shumë i ngjanë stinës së vjeshtës, por që në atë ambient për një kohë të shkurtër paraqitën mijëra kameleonë me lloj-lloj ngjyrash dhe lloj-lloj pamje, të cilët vjellin helm. Kjo ëndërr, gjithmonë fikzionale paraqet realitetin, në të cilin vetë kishte shqiptarë, të cilët për interesa personale i shërbyen pushtetit dhe i luftuan organizatorët e demonstratave, për hir të interesave të tyre personale. Helmi i këtyre kameleonëve ishte më i keq se sa edhe vetë tortura e pushtetit. Në lidhje me këtë, studiuesi Adil Olluri thekson se *mundimet mbi individin nuk i shkaktoi vetëm regjimi si totalitet, por edhe njerëzit që verbërisht i shërbyen atij, sepse këta të fundit ishin edhe katalizatorë të së keqes*.²⁹

Rexhep Qosja përballë Çarem Çaparit

Në teoritë tradicionale të letërsisë, por edhe në ato moderne e postmoderne, kemi një kufi të qartë mes autorit dhe narratorit. Është fare e thjeshtë të kuptohet se autori është ai që ka shkruar veprën, ka krijuar personazhet dhe fabulën, por që nuk duhet të identifikohet me narratorin, përveç në raste të prozës autobiografike. Në anën tjetër, narratori është personi, i cili e rrëfen ngjarjen duke qenë vetë personazh aktiv në vepër si narrator në vetën e parë, apo edhe si personazh pasiv si narrator në vetën, por në raste të rralla edhe si narrator në vetën e dytë. Por,

²⁶ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 402.

²⁷ ASHAK, *Kosova- vështrim monografik*, ASHAK, Prishtinë, 2011, faqe 243-244.

²⁸ Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, faqe 406.

²⁹ Olluri, Adil, *Fytyra e tiranisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017, faqe 27.

pavarësisht nga kjo ndarje, shpeshherë autori, qëllimshëm apo pavetëdijshëm ngërthen brenda karakterit të personazhit edhe veçori të veta, apo edhe rrëfen ngjarje të cilat lidhet me jetën e tyre. Në romanin “Një dashuri dhe shtatë faje” fati i Rexhep Qosjes si autor dhe Çarem Çapari si narrator pikëtakohen në shumë ngjarje. Në ditarin “Dëshmitar në kohë historike”, vëllimi i tretë, që përfshinë ngjarjet që nga viti 1979 deri në vitin 1981, Rexhep Qosja përshkruan peripecitë e tij në raport me pushtetin pas fillimit të demonstratave të mëdha studentore të vitit 1981. Ashtu sikurse personazhi fiktiv, narratori Çarem Çapari, i cili refuzon t’i dënojë demonstratat studentore të rinisë kosovare si armiqësore, ashtu edhe personazhi real, këtë rast autori, Rexhep Qosja vepron njëjtë, pra i shmanget kundërshtimit të tyre. Çarem Çapari do të vuajë nga pushteti për shkak të qëndrimeve të tij, ku do të përcjellët nga agjentë të sigurimit shtetëror, njëllë sikur profesor Qosja, i cili do të përcjellët këmba këmbës nga Sigurimi Shtetëror Jugosllav, ku agjentët do t’i vihen pas edhe kur ai shkon në Vuthaj.³⁰ Thuajse fati i njëjtë do të jetë edhe largimi nga qyteti ku veprojnë, Çapari nga Vajazani dhe Qosja nga Prishtina, por që i pari nuk do të kthehet më, kurse Qosja do të kthehet pas disa ditëve përsëri. Në përjetimet e tija për demonstratat e 1981, Rexhep Qosja rrëfen se u detyrua të largohet nga Prishtina për një kohë drejt vendlindjes së tij në Vuthaj,³¹ për t’i ikur presionit nga agjentët e shërbimit sekret. Por që të dy, do të largohen për arsyen e njëjtë, atë që mos ta quajnë një proces të madh historik, si demonstratat e 1981 si proces i dëmshëm për vendin.

Përfundim

Vepra “Një dashuri dhe shtatë faje” e Rexhep Qosjes paraqet një pasqyrim kompleks të realiteteve historike dhe politike që kanë shoqëruar popullin shqiptar të Kosovës. Duke e përdorur fikcionin si një mjet për të eksploruar të vërtetën e të vërtetat dhe për të zbuluar identitetet e personazheve që luajtën rol në historinë kombëtare, Qosja krijon një narrativë që sfidon lexuesin semiotik të reflektojë mbi këto ngjarje Përmes personazheve të tij, ai përshkruan një shoqëri të ndarë, ku ndjenja e tradhtisë dhe besnikërisë është e pranishme, duke përfshirë figura që, përmes heshtjes së tyre kontribuuan në mbështetje të pushteteve të egra. Çarem Çapari, si kryepersonazh, simbolizon intelektualin shqiptar që përballet me sfidat e një epoke të errët, duke na sjellë në vëmendje nevojën për të mbrojtur të vërtetat dhe identitetin kombëtar. Qosja, përmes një stili letrar të rafinuar arrin që ta ndërthurë realitetin me fikcionin duke krijuar një vepër që është njëherazi letërsi artistike dhe letërsi dokumentare historike. Kjo vepër, në thelb, na fton të rishqyrtojmë historinë tonë, të kuptojmë pasojat e veprimeve tona dhe të jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e kujtesës sonë kolektive.

Referencat

- [1]. ASHAK, *Kosova- vështrim monografik*, ASHAK, Prishtinë, 2011.
- [2]. Buxhovi, Jusuf, *Kosova- nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar*, SHB Faik Konica, Prishtinë, 2012.
- [3]. Keçmezi-Basha, Sabile, *Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2008.
- [4]. Olluri, Adil, *Fytyra e tiranisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017.
- [5]. Qosja Rexhep, *Dëshmitar në kohë historike Vëllimi III*, SHB Toena, 2014.
- [6]. Qosja, Rexhep, *Çështja shqiptare- historia dhe politika*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010.
- [7]. Qosja, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2010.
- [8]. Rugova, Ibrahim, *Refuzimi estetik*, SHB Rilindja, Prishtinë, 1987.

³⁰ Qosja Rexhep, “Dëshmitar në kohë historike” Vëllimi III, SHB “Toena” 2014, faqe 455.

³¹ Qosja Rexhep, “Dëshmitar në kohë historike” Vëllimi III, faqe 452-453.